

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " BLU IMPERJAL "

Sot me daten 27 Dhjetor 1994 ne Tirane,une Ramazan Karoçi,i biri Aliut dhe i Gjylies,lindur me 1963 ne Tirane dhe banues po ketu ne rrugen " J.Misja ",pallati 135,shkalla 2,apartamenti 26 - vendos te themeloi shoqerine " Blu Imperjal ",ne formen e nje shoqerije me pergjegjesi te kufizuar me iniciale sh.p.k.,dhe te kerkoj regjistrimin e saj person juridik ne regjistrin tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane.

Sh.P.K. " Blu Imperjal " - eshte me " ortak te vetem " Ramazan Karoçin,i cili vendos gjishke per kete shoqeri.Shogerija do ta kete seline ne Tirane ne adresen : Rruga " J.Misja ",pallati 135,shkalla 2,apartamenti 26.

Kapitali themeltar i sh.p.k. " Blu Imperjal " eshte 100.000 leke,te depozituara dhe te transferueshme lehtesish.

Kohezgjatja e aktivitetit do te jete jo me pak se 10 vjet,nga data e krijimit te kesaj shoqerije.Administratori i kesaj shoqerije do te jete Ramazan Karoçi.Me pas kjo e drejte mund tju jepet personave te tjere,kundrejt kontratave te veganta me ta.

Aktiviteti i kesaj shoqerije do te jete: ne fushen e prodhimeve fillimisht piyeve frekuente ( uje te gazuar,limonata etj ),me pas dhe atyreve alkoolike si dhe produktave te tjera ushqimore si ato me baze brumi,qumeshti etj.Perveç fushes se prodhimit do te synohet aktivitet ne fushen e sherbimit te ushqimit social zikloeskë,bar-bufe,restorante etj.Gjithashu ne fushen e sherbimeve bankare,te transportit,asaj komunale,te shendetesise etj.Import-eksport te produktave,lendeve te para,paisjeve e makinerive per industrine ushqimore,asaj tekstile,kimike,te ndertimit,te minierave,te energjitikes etj.Paralelisht me keto synimi do te jete per investime ne turizem dhe ato fusha qe do te percaktohen me interes.

Pra aktiviteti i kesaj shoqerije do te synoje qe te perfshihe te gjitha fushat e lejuara nga legjislationi shqipetar.

Fitimi neto i shoqerise,do te rezultoje mbas zbritjes se ta ardhurave bruto dhe shpenzimeve te tjera qe kane lidhje me aktivitetin e shoqerise.Fitimi neto i takon themeluesit dhe pronarit te vetem Ramazan Karoçi

Konfliktet qe mund te lindin gjate aktivitetit te sh.p.k. " Blu Imperjal ",do te shqyrtohen nga Gjykata e Rrethit Tirane,me perjashtim te styre rasteve qe ne dokumente te veganta cilesohen ndryshe.

S T A T U T

I SHOQERISE TREGETARE " BLU IMPERJAL " SH.P.K.

Ne mbeshtetje te Ligjit 7512 date 10.08.1991 " Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private... " : Ligjit 7632 date 4.11.1992 " Per dispozitat qe rregullojne pjesen e pare te Kodit Tregetar " : te Ligjit 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregetare " dhe te Ligjit 7667 date 28.01.1993 "Per regjistrin tregetar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregetare ",une Ramazan Karoçi krijoj shoqerine " Blu Imperjal " sh.p.k,aktiviteti i te ciles bazohet dhe mbi kete statut.

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Neni 1

- Shoqerija quhet " Blu Imperjal "
- Themelohet nga Ramazan Karoçi banues ne qytetin e Tiranes ne rrugen " J.Misja ",pallati 135,shkalla 2,apartamenti 28.

Neni 2

- Shoqerija " Blu Imperjal " eshte shoqeri me pernjegjesi te kufizuar,e shprehur me inicialet SH.P.K. - qka do te thote qe themelohet per te zhvilluar aktivitet privat me qellim realizim fitimi,ose perfitim te ardhurash qe rrjedhin prej saj.Po keshtu te paguaj humbjet deri ne vleren e kontributit ne kapitalin themeltar.

Neni 3

- Shoqerija " Blu Imperjal " sh.p.k. fiton personalitetin juridik nga data e regjistrimit ne regjistrin tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane, dhe fillon aktivitetin e saj privat,prodhues,perpunues,tregetar,ekonomik mbas marrjes se lejes perkatese nga organi Tatimor - Financiar te qytetit ku ai do te zhvilloje aktivitet.

Neni 4

- Shoqerija " Blu Imperjal " sh.p.k. e zhvillon veprimtarine ne perputhje me statutin dhe dokumentet e krijimit te saj,mbeshtetet ne Legjislatacionin tregetar shqipetar,dhe ne rast te situatave qe nuk jane parashikuar,bazohet ne Kodin Civil te Republikes Shqipetare.

Neni 5

- Qellimi i krijimit te kesaj shoqerije eshte ne radhe te pare, zhvillimi i aktivitetit prodhues,atij tregetar import-eksport e me pas ne fushen e investimeve,duke mos perjashtuar asnje fushe qe Lejon Legjislacioni Shqipetar.

 Duke i bere nje permblehdje te koncentruar objektit te vepri-

mtarise te kesaj shoqerije, ai do te jetet :

- Zhvillim te aktivitetit prodhues ne fushen e pijeve freskuese ( uje te gazuar, limonata ), te pijeve alkoolike, te produkteve te ndryshme ushqimore me baze brumi, qumeshti etj.

- Aktivitet privat ne fushen e ushqimit social nepermjet kioskave, bar-bufeteve, restoranteve etj.

- Import-eksport te paisjeve dhe makinerive, lendeve te para dhe produkteve ushqimore, te industrise tekstile, kimike, te ndertimit, te minierave, energjitikes etj.

- Aktivitet privat ne fushen e transportit pa kufizim ( tokso, detar etj ).

- Aktivitet privat ne fushen e sherbimeve komunale, te shendetese, asaj bankare etj.

- Zhvillim te aktivitetit investues ne te gjitha fushat e lejuara nga legjislacioni shqipetar.

#### Neni 6

- Shoqerija " Blu Imperjal " e ka seline ne kryeqytetin e Republikes Shqipetare Tirane ne rrugen " J.Misja ", pallati 135, shkalla 2, apartamenti 28.

#### Neni 7

- Shoqerija gezon te drejten te jetet antare e dhomes se Tregetise Shqipetare, te kete llogari rrjedhese ne nje ose me shume banka ne Shqiperi ose jashte saj, si dhe te kete vulen e saj. Gjithashtu shoqerija " Blu Imperjal " mund te cele filiale, dege e perfaqsi jo vetem ne qytete te tjera te Shqiperise por dhe jashte saj.

#### Neni 8

- Aktiviteti i shoqerise " Blu Imperjal " do te zhvillohet i pa-percaktuar ne kohe, por ai do te jetet minimalisht, nga data e themelimit, jo me pak se 10 vjet.

#### KREU II

#### KAPITALI DHE KRITERET EKONOMIKE

#### Neni 9

- " Ortaku i vetem " krijon kapitalin fillestar te shoqerise, te cilin e posedon plotesisht. Ajo eshte derdhje ne para. Vlera e kapitalit fillestar te shoqerise " Blu Imperjal " eshte 100.000 leke dhe krijohet nga derdhja qe do te beje Ramazan Karogi.

Kapitali themeltar eshte lehtesish i transferueshem sebashtku me te ardhura te tjera, si brenda dhe jashte vendit.

Ulja e kapitalit fillestar nen 100.000 leke, e shndrron shoqerine ne nje forme tjeter. Ky ndryshim mund te behet dhe nga Gjykata me kerkesen e te interesuarit.

Kapitali themeltar dhe pjesa te tij jane lehtesish te transferuese ne rruge trashgimije,sipas percaktimeve qe ben Ligji 7638 date 19.11. 1992 " Per shoqerite Tregetare ".  


Neni 10

- Shoqerija krijon fondin rezerve ne masen 10 perqind te kapitalit themeltar.Per kete qellim qdo tremujor behen zbritje nga fitimi deri ne masen e krijimit te fondit te percaktuar.

Neni 11

- Krijohet fondi i ndihmes dhe i shperblimeve.Ky fond ka per qellim nxitjen dhe zhvillimin e aktivitetit te shoqerise.Fondi krijohet qdo vit duke bere zbritje nga fitimi ne masen 5 perqind.

Fondet e paperdorura te nje periudhe,mbarten per tu perdorur ne periudhen pasardhese.

Neni 12

- Veprimtarija financiare e shoqerise pasqyrohet ne dokumentacionin perkates dhe ne periudha te caktuara saktosohet ne bilancet e saj,qe nuk mund te jene me te pakta se nje here ne vit.

Format e dokumentacionit dhe bilanci mbahen sipas kritereve te percaktuara nga organet shteterore shqiptare.

Neni 13

- Fitimi neto rezulton mbas zbritjes se pagave,shpenzimeve te transportit,magazinazhit,smortizimit,shpenzimeve te reklames.

Detyrimet eventuale qe mund ti lindin shoqerise gjate zhvillimit te aktivitetit te saj mund te mbulohen nga fondi rezerve,i ndihmes,i shperblimeve - kurdochere me miratim te pronarit.

KREU III


DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 14

- Per shoqerine kurdochere vendos themeluesi dhe pronari i vetem i saj,Ramazan Karoçi.Ai gezon te drejten per te vendsur per te gjitha geshtjet,por ne veçanti per :

- a). Ndryshimet e statutit.
- b). Per zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar.
- c). Per shndrrimin e shoqerise nga shoqeri me perjegjesi te kufizuar,ne kolektive,komandite apo anonime.
- d). Pushimin e aktivitetit te shoqerise.
- e). Emrimin dhe pushimin e administratorit dhe ekspertit ( kontabel ) nese do te kete.

Neni 15

  
- Shoqerija " Blu Imperjal " do te administrohet fillimisht nga

Ramazan Karoçi, por kjo nuk e privon ate qe kundrejt nje kontrate te veçante, te zgjedhe dhe te vendose administratore nje person tjeter, me afat te caktuar.

Neni 16

- Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marrhenije me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrrethanat, me perjashtim te kompetencave qe ky statut, sipas Nenit 14 te tij ja jep shprehimi-sht pronarit. Ky nen funksionon kur administrator nuk eshte vete pronari.

Shoqerija per gjigjet per aktet e administratorit edhe kur keto nuk perfshihen ne objektin e shoqerise, por ajo nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve, kur keta te fundit e dinin qe akti i administratorit e kaloente objektin e shoqerise, ose te tretet nuk mund ta injoronin kete nga rrrethanat.

Neni 17

- Administratori paraqet raport per marreveshjet qe ka arritur me te tretet, vete ai ose me ndermjetes. Ne lidhje me raportin vendos " ortaku i vetem ". Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga pronari, qe i sjellin dem shoqerise i ngarkohen administratorit per ti perballuar individualisht.

Administratori nuk mund te jete antar i nje shoqerije tjeter ekonomike ( me per gjegjesi te kufizuar ) qe kryen aktivitet te ngjashem me shoqerine e tij. Po per te njejtat rrrethana ai nuk mund te jete me detyre drejtimi ne nje shoqeri tjeter.

Neni 18

- Te drejten e marrjes ne pune te punonjesve e ka administratori, sipas nje kontrate te veçante me ta.

Neni 19

- Administratori ngarkohen dhe shkarkohet nga pronari, por ai mund te shkarkohet dhe nga Gjykata per shkelje te ligjit.

Neni 20

- Kontrolli i veprimtarise financiare realizohet nga sektori ekonomik, punonjesit e te cilil caktohen nga pronari Ramazan Karoçi.

Neni 21

- Sektori ekonomik eshte per gjegjes per veprimtarine e vet perpara " ortakut te vetem " - pronarit Ramazan Karoçi, dhe i paraqet here pas here por jo me pak se dy here ne vit raporttet per kontrolllet dhe bilancin. Kuptohet qem me kerkesen e pronarit, kjo mund te behet ne çdo kohe.

Neni 22

- Perveç te drejtave, pronari - " ortaku i vetem " - ka edhe këto detyrime :

 Te depozitoje kuotat sipas Nenit 8 te ketij statuti.

Te marre pjese ne drejtimin dhe administrimin e shoqerise,vete dhe nepermjet organeve qe vete ai do te emroje.

Ti jape shoqerise informatat e nevojeshme per perpunimin e çdo objektivi qe ka te beje me veprimtarine e saj.

Neni 23

- Gjate zhvillimit te aktivitetit te shoqerise " Blu Imperjal ", ne rast konfliktesh qe mund te kete,ato do te shqyrtohen nga Gjykata e Rrethit Tirane,perjashtohen ketu kontratat e veçanta ku mund te jete cilesuar ndyshes.

Neni 24

- Ky statut hartohet ne kater kopje te cilat respektivisht do te depozitohen : nje prane Gjykates se Rrethit Tirane: nje ne organin Tatimoro-Financiar qe do te leshoje lejen e ushtrimit te veprimtarise:njera nga noteria qe do te beje noterizimin e tyre dhe tjera nga pronari i saj.

PRONARI I SHOQERISE " BLU IMPERJAL "

Tirane, me 28.12.1994

RAMAZAN KAROÇI

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E DREJTESISE  
NOTERIA - TIRANE

Nr. 813 Rep  
Nr. 180 Kol

V E R T E T I M

Sot me daten 1.2.1994 ( nentedhjete e ~~pato~~ ), ne zyren e noterise Tirane, para meje NOTERE ARIANA MALLKUÇI, notere ne kete qytet,u paraqit personalisht Ramazan Karoçi i biri Aliut dhe i Gjylies,lindur me 1963 ne Tirane ku dhe banon ne rrugen " J.Misja ", pallati 135, shkalla 2, apartamenti 28, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga leternjëftimi personal 04343883, i cili deklaroi se statuti i redaktuar jashtë kesaj zyre eshte shprehje e vullnetit te tij te lire e te plote,nenshkroi perpara meje dhe une e vertetoj kete sipas ligjit.

NOTERE  
ARIANA MALLKUÇI

